

Ministri i Drejtesise

ju informon:

---

## Ndihme e pare juridike per mbrojtje nga një Avokat

Çdo person, i cili për një vepër të kryer apo për një vepër të dyshuar ose për një vepër penale të kryer, ka të drejtë për mbrojtje ligjore nga një Avokat dhe ta zgjedhe një mbrojtës për mbrojtjen e tij/saj sipas nenit (§ 58 StPO).

Ju jeni ndalur posaçërisht arrestuar si i dyshuar për kryerje të një veprë penale dhe ju keni të drejtë të merreni kontakt me një mbrojtës posaçërisht me një Avokat. Për këtë arsye me iniciativën e Dhomës së Avokateve të Austrisë dhe të Ministrisë së Drejtësisë ky institucion posaçërisht ky vend mund të përdoret në baze të kushteve të cekura si më poshtë:

Ky vend juridik mbrojtës i përfshin një thirrje telefonike me kërkesë e të pandehurit apo edhe një bisedë personale me një Avokat ose Avokate dhe në rast nevojë edhe gjatë marrjes në pyetje sipas (§ 164 StPO) si në lidhje me mbrojtjen e parë juridike (si për shembull kërkesës për ndihme juridike në gjykatë). Dhoma e Avokateve të Austrisë për këtë arsye operon një numër për ndihme juridike (“Hotline”), që është për çdo ditë i arritshëm prej 0:00 deri me 24:00 dhe në rast për ndihme juridike ose për mbrojtje juridike nga një Avokat. Në këtë rast është në kontakt një Avokat ose Avokate për ndihme juridike dhe mund të kërkohet në formë telefonike për mbrojtje.

Në këtë rast që ju e keni caktuar një Avokat për mbrojtje vlen vetëm derisa ju të dërgoheni në burg ose derisa ju të liroheni në liri. Qëndron po ashtu mundësia që ky Avokati ose Avokate edhe me vone prej juve të autorizohet për mbrojtje e juaj edhe në vazhdim.

Thirrje e parë telefonike me një Avokat posaçërisht për mbrojtje është falas.

Në këtë bisedë telefonike ju do të këshilloheni për llojin, fushën, dhe pagesën për hapat e tjerë të mëtejshëm, të cila mund të merren nga ky Avokat për ndihmën e parë juridike.

**Hotline: 0800 376 386**

---